



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:283739
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05522462

Ac.nr.4794/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula – Kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit S.S nga fshati K....., Komuna V....., të cilin me autorizim e përfaqëson T.A, avokat në Viti, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt të kontestit shpërblimi i pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.1173/2021, i datës 24.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, C.nr.1173/2021, i datës 24.05.2023, në pikën I dhe III të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1173/2021, i datës 24.05.2023, ka vendosur si në vijim: “*LAPROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.S nga fshati K....., Komuna V..... dhe DETYROHET e paditura Policia e Kosovës me seli në Prishtinë,*

që në emër të shpërblimit të pagës së 13 (trembdhjetë) ekuivalente me një pagë mujore në shumën prej 567.17 €, për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, ashtu që për vitin 2018, 2019 dhe për vitin 2020, të ia paguaj në total shumën e përgjithshme prej 1,701.51 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 16.12.2021 si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

II. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për tej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit, të cilën e ka kërkuar në emër të shpërblimit të pagës së 13 (trembdhjetë) për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në shumën prej 760.82 euro si dhe shumën prej 1,818.00€, në emër të kompensimit për shujtë ditore, për periudhën e njëjtë kohore si në pikën I të dispozitivit, përkatësisht për 606 ditë pune.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 124€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe aktgjykimin ta prishë dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 16.12.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, ndërsa me datën 17.05.2023 ka precizuar kërkesëpadinë përmes së cilës ka kërkuar ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të pagave së trembdhjeta për vitin 2018, 2019 dhe 2020 t'ia paguajë paditësit shumën në lartësi prej 2468.33 € euro dhe në emër të shpërblimit për ushqimin ditor (shujtave ditore) t'ia paguajë kompensimin për 606 ditë nga tri euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, precizimit të saj, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 8 e lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, jashtë seance ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1173/2021, i datës 24.05.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të themeltë kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar te e paditura, pasi kjo vërtetohet në bazë të vërtetimit të punësimit, ndërsa pagën për periudhën kohore për të cilën e ka parashtruar padinë e ka bazuar në vërtetimit të punësimit të lëshuar nga e paditura. Po ashtu gjykata ka vërtetuar faktin e punësimit të paditësit te e paditura, pagën e muajit dhjetor për vitin 2018, 2019 dhe 2020 në bazë të vlerësimit të performancës së paditësit për vitin 2018, 2019 dhe 2020, ku është vlerësuar me vlerësim tejet të kënaqshme duke realizuar të ardhura neto 588.42 €.

Tutje gjykata e shkallës së parë ka shtuar se e paditura ka pasur detyrim që paditësit si i punësuar i saj t'ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi janë plotësuar kushtet nga ana e paditësit si parashihen me nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018, me saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2018, 2019 dhe 2020, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Vendimin e ka bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 e LPK-së (që kuptohet nga përmbajtja e ankesës). Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e pagave është parashtruar, kjo gjykatë vlerësoi se një pretendim të tillë nga e paditura nuk e ka parashtruar gjatë shqyrtimit gjyqësor të shkallës së parë, ku tani nuk mund të paraqitet, ngase sipas nenit 180.3 të LPK-së, parashihet se “ *Prapësimi i parashkrimit dhe prapësim me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë*”, andaj një pretendim i tillë është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi është nxjerr pa u plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 398 të LPK-së, sepse në rastin konkret janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për marrjen e të njëjtit sipas nenit 152 lidhur me nenin 398 të LPK-se.

Në raport me pretendimin për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike po ashtu kjo nuk qëndron, sepse nga provat e administruara dhe vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë vërtetuar këto fakte: punësimi i paditësit te e paditura, vlerësimi pozitiv i paditësit nga e paditura për vitin 2018, 2019 dhe 2020 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore, lartësia e pagave është vërtetuar me dokument zyrtar siç është lista e pagave dhe është bazuar në pagën e muajit dhjetor, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 567.17 € dhe ka notën 4 që korrespondon me vlerësim të kënaqshëm duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që e paditura nuk ka arritur të provojë se ia ka kompensuar paditësit pagat e kërkuara.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e procedurës nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditësit nuk hyn në kategorinë e çështjeve për tu ngritur konform nenit 78 fillimisht te e paditura e më pastaj konform nenit 79 në gjykatë, për arsye se nga ana e punëdhënësit nuk ka ndonjë vendim paraprak të cilin do ta godiste paditësin, por ka detyrim të përmbushjes nga ana e të paditurës.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës ne Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29.1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2. përcaktohet se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore ne fund te vitit”*.

Paditësi i plotëson kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që është në marrëdhënie pune te e paditura, nuk ka pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitin kontestues 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa ka pasur vlerësim të mirë për këtë vit, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të referencës së të paditurës si dokument publik të lëshuar.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Lidhur me kamatën është vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ku përcaktohet lartësia prej 8% në vit dhe Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, ndërsa e njëjta fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë pasi bëhet fjalë për dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën II të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4794/2023, me datë 28.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v